



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC**

DËGJESË PUBLIKE PËR PROJEKT BUXHETIN E VITIT 2020 (BUÇIMAS)

Pogradec më , 09.10.2019

Bashkia Pogradec, Kryetari i saj z. Ilir Xhakolli ka nisur konsultimin me publikun në lidhje me përgatitjen e projekt-buxhetit për vitin 2020. Në këto takime kryetari është shoqëruar nga kabineti i tij dhe drejtorë të drejtorive vartëse. Takimet kanë si synim mbledhjen e kërkesave të banorëve dhe investimeve apo ndërhyrjeve emergjente që kërkohen nga ana e tyre. Në këto takime kanë marrë pjesë kryetarët e fshatrave respektive, banorë, biznese dhe grupe të ndryshme interesi. Në dt 09.10.2019 dëgjesa u zhvillua një njësinë administrative Buçimas me prani të përmendur si më lart. Në këtë dëgjese të hapur banorët dhe kryepleqtë kanë renditur një sërë kërkesash si më poshtë në mënyrë që ato të bëhen pjesë e buxhetit për vitin e ardhshëm.

KËRKESAT NGA FSHATI STAROVË

- Sistemim të kanalizimeve të urjave të zeza pasi nuk janë përfunduar plotësisht.
- Rrethimi, zgjerimi dhe mirëmbajta e varrezave publike
- Rikonstruksion total të shkollës së mesme
- Investim në rrjetin rrugor të brendshëm të këtij fshati
- Përmirësim të pastrimit të mbetjeve, kanaleve etj.

KËRKESAT NGA FSHATI GURAS

- Sistemim të kanalizimeve të ujrave të zeza
- Mirëmbajtje të varrezave dhe rrethim të tyre në hyrje të këtij fshati
- Investim për rikonstrukcionin e hyrjes së Gurasit
- Punonjës pastrimi për mirëmbajtjen e fshatit, rrugëve dhe kanaleve
- Tabela orientuese + sinjalistikë rrugore në drejtim të fshatit Guras
- Investim në rrjetin rrugor të brendshëm

KËRKESAT NGA FSHATI ZËRVASKË

- Sistemim të sistemit të kanaleve për ujrave të zeza
- Rrethim të varrezave publike dhe mirëmbajtje e tyre.
- Puntorë mirëmbajtjeje për fshatin
- Vendosje e ndriçimit rrugor në rrugët ku mungon
- Krijimi i aksesit për kalim në parcelat bujqësore përfshi këtu edhe në segmentin e ri të unazës në Bahçallëk
- Rritje të vëmendjes për pastrimin e kanaleve kullues dhe vaditës.

KËRKESAT NGA FSHATI VËRDOVË

- Përfundimi i kanalizimeve të ujrave të zeza
- Infrastrukturë rrugore të brendshme
- Investim për rehabilitimin e lumit të Vërdovës
- Dhënia prioritet prodhimit të fermerëve për shitjen e tij.

KËRKESAT NGA FSHATI TUSHEMISHT

- Sistemim të kanaleve kullues dhe sistemit vaditës
- Hapja e rrugëve lidhëse në parcelat bujqësore
- Përfundimi i kanalizimeve të ujrave të zeza
- Mirëmbajtje të varrezave
- Në lagjen e sipërme investim në rrugë, ndriçim dhe kanalizime

KËRKESAT NGA FSHATI RRËMENJ

- Pastrimi i lumit të fshatit
- Dëmshpërblimet nga përmbytjet e viteve të kaluara
- Rritje të vëmendjes për varrezat publike dhe pastrimit

KËRKESA NË LIDHJE ME TAKSAT

Ulje të tarifave në lidhje me niptet sekondare të bizneseve të mëdha

Ulje të tarifës së tokës për metër katrorë

Largimi i ambulantëve të paliçensuar që shesin pranë insititucioneve arsimore

PJESËMARRËS NË DËGJESË

Kryetari i bashkisë	z. Ilir Xhakolli
Zv/ Kryetari	z. Bledi Çomo
Zv/Kryetari	z. Pasklino Ziko
Shefi Kabinetit	znj Alma Pano
Këshilltari për Mediat	z. Artin Halili
Drejtori i Tatim-Taksave	z. Vladimir Mato
Drejtori i Finacave	znj. Irsa Karapança